



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

VENDIM

Nr. 11_ Data 04.08.2017_

Për miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor të rrjedhës së përrrenjve të Soponicës ndodhen në pjesën e mesme të lumit të Dëshnicës degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Suka 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Këlcyrë, qarku Gjirokastrë subjektit "J-ENERGY" sh.p.k., me administrator Z. Enea Durmishi

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni",

VENDOSI

Miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor të rrjedhës së përrrenjve të Soponicës ndodhen në pjesën e mesme të lumit të Dëshnicës degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Suka 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Këlcyrë, qarku Gjirokastrë subjektit "J-ENERGY" sh.p.k., me administrator Z. Enea Durmishi me këto të dhëna:

Koordinatat: X 4425890; Y 4471820; Z 460
X 4425720; Y 4471920; Z 460

Prurja mesatare: 0.115 m³/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLI I BASENIT UJOR “VJOSË”

Prurja e llogaritur: 0.240 m³/sek

Prurja e ekologjike: 0.012 m³/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë 320 kW

Për përdorimin e këtij burimi ujqor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”


Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U “VJOSË”


Etjona HOXHA